



Të dhënat e kontaktit të dhënësit tënd:

Emri i dhënësit:

Vendi i punës:

Numri i telefonit:

Emri i marrësit të kujdesit shëndetësor:

Nënshkrimi/firma

Të dhënat e kontaktit të Qendrës së mjeteve ndihmëse

Shërbimi i klientit

tel. 0455 – 73 63 35

e-posta: hjalpmedelscenter@ltblekinge.se

Adresa e selisë: Skrädderivägen

371 55 Karlskrona

**Atë çka ti ke nevojë
të dish për mjetin tënd
ndihmës**



Përgjegjësia jote

Mjetet ndihmëse duhet të përdoren sipas atyre udhëzimeve të cilat janë të shënuara në udhëzimin e përdorimit si dhe sipas informacionit që ti merr nga dhënësi yt.

Secilin mjet ndihmës shoqërohet nga një përgjegjësi për t'u kujdesur për të, të pastrosh dhe të mirëmbash atë.

Je ti ose i afërmi yt/kujdestari yt i cili është përgjegjës për mjetin ndihmës gjatë kohës së huazimit.

Është Këshilli i Qarkut Blekinge që është pronar i mjetit ndihmës. Nuk lejohet të shesësh atë ose të huazosh mjetin ndihmës.

Nëse mjeti ndihmës pëson nga amortizimi i tepruar, dëmet të shkaktuara nga ti, e humbë atë ose ta vjedh dikush, për këto je ti që detyrohesh të kompensosh. Prandaj është me rëndësi që ti të kontrollosh mbrojtjen që ke përmes sigurimit të shtëpisë.

Kur të dorëzohen ty mjetet ndihmëse, përfshihet një komplet i materialit të përdorimit. Më pas, duhet vet marrësi i kujdesit shëndetësor t'i mbuloj shpenzimet për këto gjëra:

- Bateritë (A, AA, AAA, 9-volt dhe bateritë për orët)
- Pjesët rezervë dhe maskën për CPAP
- Pllakat e elektrodave për TENS

Riparimet e dëmtimeve që kanë ndodhur në rrethinën tënde p.sh. në banesën tënde kur e ke përdorur mjetin ndihmës, nuk paguhen nga Këshilli i Qarkut ose nga komuna.

Dëmtim ose humbje

Kontakto dhënësin tënd në rast dëmtimi, humbje/vjedhje, aksidentit/ngjarje e rrezikshme me mjetin ndihmës.

Në rast të vjedhjes, ti duhet të bësh një lajmërim në polici si dhe të ndërmarra jote e sigurimit.

Shërbimi dhe riparimet

Shërbimi dhe riparimet janë falas për ty, kur bëhet fjalë për amortizim normal. Kontakto, në rend të parë, dhënësin tënd.

Ti, po ashtu, mund të kontaktosh Shërbimin teknik në Qendrën e mjeteve ndihmëse, orari i telefonatave e hënë – e premte 8.00 – 9.00, 13.00 – 14.00. Në kohët e tjera mund të lësh mesazh me zë në sekretarinë e telefonit, tel. 0455 – 73 63 35
e-posta: tekniskservice.hmc@ltblekinge.se

Shpërngulja

Në rast shpërngulje si brenda dhe jashtë qarkut, ti duhet të kontaktosh dhënësin tënd me kohë, para se të shpërngulesh.

Në rast shpërngulje jashtë qarkut, mjeti ndihmës duhet zakonisht të kthehet. Mjet tjetër ndihmës mund të marrësh në vendbanimin tjetër ku do të shpërngulesh.

Nëse e merr me vete mjetin ndihmës pa kontaktuar dhënësin, je ti vet përgjegjës për t'ia kthyer mjetin ndihmës Këshillit të Qarkut në Blekinge.

Kthimi prapa

Kur nuk ke më nevojë për mjetin ndihmës, atë duhet ta kthesh në gjendje të pastër. Edhe përkundë vërejtjes nga dhënësi për të kthyer mjetin ndihmës, ti do të detyrohesh të kompensosh atë. Kontakto dhënësin tënd ose Qendrën e mjeteve ndihmëse, tel. 0455- 73 63 35